



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 145, Datë 25.06.2018

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E ALIKIMIT TË SHOQËRISË
“FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË” SH.A, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “ç” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenit 4, pika 1, gërma “d”; nenit 10 pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, dhe nenit 19 pika 1, gërma “a” të “Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr.96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 25.06.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për licencimin e shoqërisë “FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË” sh.a, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Me shkresën nr. 7818 Prot., datë 27.04.2018, protokolluar me tonën nr. 355 Prot., datë 30.04.2018, OSHEE sh.a, ka përcjellë dokumentacionin për transferimin e licencave dhe licencimin e shoqërive të kontrolluara nga ana e saj. Ndër to, është edhe dokumentacioni i shoqërisë “Furnizuesi i Tregut Të Lirë” sh.a (FTL sh.a), për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
Me shkresën Nr. 2/1 Prot., datë 28.05.2018, “FTL” sh.a, ka paraqitur në ERE kërkesën për tu pajisur me licencë në veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike.
- Aplikimi i shoqërisë “FTL” sh.a, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
 - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.7), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit për licencim të shoqërisë “FTL” sh.a, në në veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.